



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI  
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES  
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr.03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

**D e k r e t o j**


Ratifikimin e Marrëveshjes Për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, e nënshkruar në Prishtinë me datë 31 maj 2011, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 05 korrik 2011.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-014-2011

Prishtinë, më 11 korrik 2011

  
Atifete Jahjaga  
Presidente e Republikës së Kosovës

**MARRËVESHJE**  
**PËR**  
**NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJE PENALE**  
**NDËRMJET**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË**

**PREAMBULA**

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, këtej e tutje të referuara si "Palët";

Në aspiratat e tyre për zhvillimin dhe fuqizimin e mëtutjeshëm e marrëdhënieve bilaterale sa i përket ndihmës së ndërsjellë juridike në çështje penale ndërmjet dy shteteve;

Duke marrë parasysh miqësinë dhe bashkëpunimin ndërmjet dy Palëve dhe gatishmërinë për pjesëmarrje aktive në procesin e bashkëpunimit në Evropë;

Janë pajtuar me sa vijon:

poashtu kurdo që kërkohet një përshkrim i dëshmisë apo deklaratës së kërkuar nga shteti kërkues i cili e parashtron kërkesën për ndihmë juridike të ndërsjellë.

4. Kërkesa dhe dokumentet përcjellëse duhet të nënshkruhen dhe të vulosen nga autoritetet kompetente të Palës kërkuese.

#### Neni 4

##### Refuzimi i ndihmës juridike të ndërsjellë

1. Kërkesat për ndihmë juridike të ndërsjellë mund të refuzohen nga Pala e kërkuar në ndonjë nga rastet si në vijim:
  - a) nëse hetimi ose procedura penale ka të bëjë me:
    - i) veprë penale të cilën Pala e kërkuar e konsideron veprë penale politike ose veprë lidhur me veprë penale politike; ose
    - ii) veprë penale ushtarake e cila nuk paraqet një veprë penale sipas ligjit të zakonshëm penal.
  - b) nëse Pala e kërkuar konsideron se ekzekutimi i kërkesës mund të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik dhe interesat e tjera esenciale.
2. Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, terrorizmi dhe veprat për të cilat ndjekja dhe procedura penale nga Palët Kontraktuese obligohet në bazë të marrëveshjeve shumëpalëshe dhe ndërkombëtare, nuk konsiderohen vepra penale politike ose vepra lidhur me veprë penale politike.

#### Neni 5

##### Veprimi lidhur me Kërkesat

- (1) Nëse Pala e kërkuar konsideron se kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë nuk përputhet me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose nuk mund të ekzekutohet sipas ligjeve të saj, ajo duhet menjëherë ta informoj palën kërkuese dhe t'i specifikoj arsyet.
- (2) Me ekzekutimin e kërkesës për ndihmë juridike të ndërsjellë, Pala e kërkuar duhet t'ia kthej Palës kërkuese kërkesën origjinale së bashku me të gjitha dokumentet, të dhënat ose provat e siguruara.
- (3) Nëse autoriteti të cilit i drejtohet kërkesa nuk është kompetent për ekzekutim, Pala e kërkuar duhet të përcjellë atë tek autoriteti kompetent.

## KAPITULLI II LETËR POROSITË

### Neni 6 Letër Porositë

1. Secila Palë mund të dërgojë letër porosi tek autoritetet kompetente të Palës tjetër, me qëllim të sigurimit të provave ose përcjelljen e sendeve për sigurimin e provave, regjistra apo dokumente.

### Neni 7 Ekzekutimi i Letër Porosive

1. Pala e kërkuar do të ekzekutojë letër porosinë të drejuara nga Pala kërkuese në pajtim me procedurën dhe në mënyrën e paraparë me ligjet e saj.
2. Në bazë të kërkesës, Pala e kërkuar gjatë ekzekutimit të letër porosive mund ta zbatojë një procedurë të veçantë të kërkuar nga Pala kërkuese deri në atë masë në të cilën procedura e tillë është në pajtim me ligjin e saj.
3. Nëse Pala kërkuese kërkon nga dëshmitarët ose ekspertët dhënien e dëshmisë nën betim, atëherë duhet të kërkojë atë shprehimisht në kërkesën e saj. Pala e kërkuar do të përmbush një kërkesë të tillë nëse konsideron se është e pranueshme sipas ligjeve të saj.
4. Pala e kërkuar do t'ia përcjellë Palës kërkuese kopjet e vërtetuara të dokumenteve dhe provave të kërkuara, përveç kur Pala kërkuese shprehimisht kërkon dërgimin e origjinaleve.
5. Me pëlqim e Palës së kërkuar, zyrtarët përkatës të Palës kërkuese dhe personat tjerë të interesuar ose përfaqësuesit e tyre mund të jenë prezent, si vëzhgues, gjatë ekzekutimit të letër porosisë.
5. Për këtë qëllim dhe në bazë të kërkesës së Palës kërkuese, Pala e kërkuar duhet ta informoj me kohë Palën kërkuese për datën dhe vendin e ekzekutimit të letër porosisë.

### Neni 8 Kontrollimi dhe Sekuestrimi i Pasurisë

Pala e kërkuar do të ekzekutojë letër porositë për kontrollimin dhe sekuestrimin e pasurisë në rastet kur:

a) vepra penale e cila e motivon letër porosinë është e dënueshme me ligjin e Palës kërkuese dhe të Palës së kërkuar

b) ekzekutimi i letër porosisë është në pajtim me ligjin e saj.

#### Neni 9

#### Dorëzimi dhe Kthimi i Dokumenteve dhe i të Dhënave

1. Pala e kërkuar mund ta vonoj dorëzimin e çdo pasurie, të dhëne ose dokumenti të kërkuar, nëse pasuria, të dhënat ose dokumentet e tilla janë të nevojshme lidhur me procedurën penale në pritje.
2. Para refuzimit apo shtyrjes së ndihmës, Pala e kërkuar kur është e nevojshme dhe pas konsultimit me Palën kërkuese, mund të përmbush kërkesën pjesërisht, apo mund të kushtëzojë përmbushjen e kërkesës ashtu siç e sheh të nevojshme.
3. Çdo pasuri si dhe çdo e dhënë apo dokument i dorëzuar gjatë ekzekutimit të letër porosisë do të kthehet sa më shpejt që të jetë e mundur nga Pala kërkuese tek Pala e kërkuar, përveç rasteve kur kjo e fundit heq dorë nga kthimi i tyre.

### KAPITULLI III

#### SHËRBIMI I LETËRTHIRRJEVE DHE DOKUMENTEVE GJYQËSORE – PARAQITJA E DËSHMITARËVE, EKSPERTËVE DHE PERSONAVE TË NDJEKUR

#### Neni 10

#### Shërbimi i Letër thirrjes dhe Dokumenteve Gjyqësore

- (1) Pala e kërkuar do të ekzekutojë shërbimin e urdhëresave dhe vendimeve gjyqësore të cilat i ka pranuar nga Pala kërkuese.
- (2) Shërbimi mund të bëhet përmes përcjelljes së urdhëresës apo dokumentit gjyqësor tek personi të cilit duhet dorëzuar. Nëse Pala kërkuese shprehimisht e kërkon një gjë të tillë, shërbimi do të bëhet nga Pala e kërkuar në mënyrën e paraparë për shërbimin e dokumenteve për dokumente të tilla sipas ligjit të tij, apo në një mënyrë të veçantë në pajtim me ligjin përkatës.
- (3) Dëshmia e shërbimit do të ipet përmes një fletëdërgese e cila përmban datën dhe nënshkrimin e personit të cilit i është shërbyer, ose përmes deklaratimit të bërë nga Pala e kërkuar se shërbimi është kryer duke theksuar formën dhe datën e një shërbimi të tillë. Një ose disa nga këto dokumente do t'i dërgohen menjëherë Palës kërkuese. Pala e kërkuar do të njoftojë Palën kërkuese se shërbimi është kryer në pajtim me ligjin e Palës së kërkuar, nëse një gjë të tillë e kërkon Pala kërkuese. Nëse shërbimi nuk

mund të bëhet. Pala e kërkuar do ta njoftojë menjëherë Palën kërkuuese lidhur me arsyet.

- (4) Secila palë do të mbaj të drejtën për t'i shërbyer shtetasit e saj me dokumente gjyqësore në territorin e Palës së kërkuar nëpërmjet zyrave të saj diplomatike apo konsullore.

#### Neni 11

##### Paraqitja e dëshmitarëve, ekspertëve, dhe personave të ndjekur para autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkuar

1. Nëse Pala kërkuuese konsideron se paraqitja personale e një dëshmitari ose eksperti para autoriteteve të saj gjyqësore është posaçërisht e nevojshme, një gjë të tillë do ta përmend në kërkesën e saj për shërbimin e fletëthirrjes dhe Pala e kërkuar do ta ftojë dëshmitarin apo ekspertin për t'u paraqitur. Pala e kërkuar do të informojë Palën kërkuuese lidhur me përgjigjen e dëshmitarit apo ekspertit.
2. Dëshmitari apo eksperti i cili nuk i përgjigjet ftesës për t'u paraqitur, shërbimi i së cilës është kërkuar nga cilado Palë, nuk do të jetë subjekt i ndonjë dënimi apo mase ndalimi në territorin e Palës së kërkuar.
3. Në rastin e paraparë në Paragrafin (1) të këtij neni kërkesat apo letërthirrjet do të përcaktojnë shumën e përafërt të rimbursimit si dhe shpenzimet e mbuluara të udhëtimit dhe ushqimit. Nëse është bërë një kërkesë e tillë, Pala e kërkuar do t'i ofrojë dëshmitarit apo ekspertit një paradhënie. Shuma e paradhënies do të ceket në letër thirrje dhe do të rimbursohet nga Pala kërkuuese.

#### Neni 12

##### Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar për t'u paraqitur si dëshmitarë para autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkuar

- (1) Personi i ndaluar, paraqitja personale e të cilit bëhet me qëllim të sigurimit të provave tjera e jo për gjykim që është kërkuar nga Pala kërkuuese, do të transferohet përkohësisht në territorin e saj me kusht që ai/ajo do të kthehet brenda periudhës së përcaktuar nga Pala e kërkuar.
- (2) Transferimi mund të refuzohet nëse:
  - a. personi i ndaluar nuk pajtohet;
  - b. nëse prezenca e tij/saj është e domosdoshme në procedurën penale në pritje në territorin e palës së kërkuar;
  - c. nëse transferimi rrezikon zgjatjen burgimit të tij/saj; ose

d nëse ekzistojnë baza tjera për mos transferimin e tij/saj për mos transferimin e tij/saj në territorin e Palës kërkuese.

(3) Personi i transferuar do të mbahet në paraburgim në territorin e Palës kërkuese dhe kur lejohet në territorin e Palës përmes së cilës është kërkuar kalimi transit, përveç atëherë kur Pala nga e cila është kërkuar transferimi zbaton lirinë e tij.

#### Neni 13

#### Garancitë për dëshmitarët, ekspertët dhe të pandehurit kur ftohen që të paraqiten para autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese

- (1) Dëshmitari apo eksperti, pavarësisht nga kombësia e tij, i cili paraqitet sipas letërthirrjes para autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese nuk do të ndiqet penalisht, të mbahet në gjendje arresti ose të jetë subjekt i ndonjë mase tjetër e cila e kufizon lirinë e tij individuale në territorin e asaj Pale për vepra ose dënime që janë kryer para nisjes së tij nga territori i Palës së kërkuar.
- (2) Personi, pavarësisht nga kombësia e tij, i ftuar për tu paraqitur para autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese për tu përgjigjur për veprimet që përbëjnë procedurën penale ndaj tij, nuk do të ndiqet penalisht të mbahet në gjendje arresti ose t'i nënshtohet ndonjë mase tjetër që kufizon lirinë e tij individuale për vepra ose dënime që janë kryer para nisjes së tij nga territori i Palës së kërkuar e që nuk është cekur në letër thirrje.
- (3) Imunitetit i paraparë në këtë nen do të pushojë atëherë kur dëshmitari ose eksperti apo personi i ndjekur, edhe pse e kanë pasur mundësinë largimit për pesëmbëdhjetë ditë rresht nga dita kur prezenca e tij nuk kërkohet më, ka qëndruar megjithatë në territorin e tij, apo pasi që janë larguar janë kthyer prapë.

### KAPITULLI IV

#### DISPOZITAT E LLOJLLOJSHME

#### Neni 14

#### Kërkesat për të dhënat gjyqësore

- (1) Pala e kërkuar do të komunikoj pjesë të informatave lidhur me të dhënat gjyqësore kur një gjë e tillë kërkohet nga autoritetet gjyqësore të Palës kontraktuese dhe se informatat e tilla janë të nevojshme në një çështje penale në të njëjtën masë se informatat e tilla do të jenë në dispozicion për autoritetet e tij gjyqësore në raste të ngjajshme.

- (2) Në çdo rast tjetër përveç atyre të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, kërkesa do të përmbushet në pajtim me kushtet e parapara me ligj, rregullore ose praktika e Palës së kërkuar.

#### Neni 15

##### Shkëmbimi i informatave gjyqësore

1. Secila Palë do ta informojë Palën tjetër për të gjitha dënimet penale dhe masat plotësuese të shqiptuara nga autoritetet e tyre gjyqësore lidhur me shtetasit e palës së fundit, që janë regjistruar në të dhënat gjyqësore.
2. Ministritë e Drejtësisë të të dy Palëve do t'i komunikojnë njëra tjetrës informacione të tilla sa më shpejt që të jetë e mundur.

#### Neni 16

##### Mbrojtja e të dhënave

- (1) Të dhënat personale të transferuara nga njëra palë në tjetrën si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së ekzekutuar sipas kësaj Marrëveshje, mund të përdoren nga Pala së cilës i janë përcjellur të dhënat e tilla, vetëm:
  - a. për qëllime të procedurave për të cilat aplikohet kjo Marrëveshje;
  - b. për procedura tjera gjyqësore dhe administrative që drejtpërsëdrejti janë të lidhura me procedurat e përmendura nën (a);
  - c. për të parandaluar një kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejt për sigurinë publike.
- (2) Megjithatë, të dhënat e tilla mund të përdoren për çfarëdo qëllimi tjetër nëse paraprakisht është dhënë pajtimi nga ana e Palës që ka bërë përcjelljen e të dhënave, ose nga personi i cili është subjekt i të dhënave.
- (3) Secila nga Palët mund të refuzoj përcjelljen e të dhënave personale të siguruara si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së përpiluar sipas kësaj Marrëveshjeje kur të dhënat e tilla janë të mbrojtura në bazë të legjislacionit të saj kombëtarë.
- (4) Secila Palë e cila përcjell të dhënat personale të siguruara si rezultat i ekzekutimit të një kërkesë të bërë në bazë të kësaj marrëveshjeje, mund të kërkoj nga Pala të cilës i janë përcjellur të dhënat që të ofroj informacione lidhur me përdorimin e të dhënave të tilla.



Neni 17

Shpenzimet nga ekzekutimi i kërkesave për ndihmë reciproke juridike

- (1) Palët nuk duhet të kërkojnë nga njëra-tjetra kompensimin e shpenzimeve si rezultat i zbatimit të kësaj Marrëveshje, përveç kur:
- a. shpenzimet që bëhen nga prania e dëshmitarëve dhe ekspertëve në territorin e Palës së cilës i parashtrohet kërkesa siç është përshkruar në Nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje;
  - b. shpenzimet që dalin nga transferimi i personit në arrest i cili parashihet në Nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje.
  - c. shpenzimet e një natyre të jashtëzakonshme.
- (2) Palët duhet të konsultojnë njëra-tjetrën me qëllim që të arrijnë një marrëveshje për pagesën e shpenzimeve të paraparë në paragrafin 1.b të këtij neni.

KAPITULLI V

DISPOZITAT PËFUNDIMTARE

Neni 18

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje duhet të aplikohen ndaj të gjitha kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë që kanë të bëjnë me aktet ose veprat penale që janë kryer pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do t'i nënshtrohet ratifikimit. Ajo do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit dhe duhet të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

Neni 20

Shfuqizimi


Secila Palë mund ta shfuqizoj këtë Marrëveshje duke i ofruar Palës tjetër një njoftim me shkrim gjashtë muaj më herët.

NË DËSHMI TË KËSAJ, Ministrat përkatës e Shteteve Palë e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.


Përpiluar Prishtinë me datë 31 maj 2011, nga dy kopje në Anglisht, Shqip dhe në gjuhën Turke.

Versionet në Gjuhën Angleze, Shqipe dhe Turke të Marrëveshjes aktuale janë njëllëj autentike. Në rast të mosmarrëveshjes, versioni në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

Për Qeverinë e Republikës  
së Kosovës

  
Prof. Dr. Hajredin Kuçi  
Zëvendës Kryeministër dhe  
Ministër i Drejtësisë  
Ministria e Drejtësisë  
Republika e Kosovës

Për Qeverinë e Republikës  
së Turqisë

  
Ahmet Kahraman  
Ministër i Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë  
Republika e Turqisë